

PROJEKT:

**MONITORIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETEVE DHE PARTIVE POLITIKE NË PERIUdhËN
PARAZGJEDHORE DHE GJATË ZGJEDHJEVE**

RAPORTI MUJOR

PËR PERIUdhËN DHJETOR 2015

Përkrahur nga:

SHKUP, 14.01.2016



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja:

1. Hyrje	3	
2. Aktivitete të TIM	4	
- Metodologjia – TIM	4	
- Thirrje për zgjedhje të vëzhguesve lokal dhe përzgjedhja e tyre	5	
- Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të vëzhguesve lokal	6	
- Kalendar i aktiviteteve	7	
- Aktivitete të regjistruara të kampanjës politike		8
3. Aktivitete të QAE	10	
4. Metodologjia e QAE	13	
5. Shpenzime buxhetore	15	
- Shpenzimi i buxhetit qendror	15	
- Shpenzimi i buxheteve të NJVL	23	
6. Rregullorja ligjore	24	
7. Resurse dhe bashkëpunëtorë të jashtëm	25	
8. Aktivitete të ardhshme të parapara	26	
9. Aneke		
- Udhëzues		
- Trajnime		

Hyrje

Në kuadër të projektit *“Monitorimi i shpenzimeve nga buxhetet dhe partitë politike në procesin parazgjedhor dhe gjatë zgjedhjeve”* gjatë muajit dhjetor 2015, ishin realizuar aktivitetet vijuese:

- Zhvillimi i metodologjive dhe veglave për monitorimin e shpenzimeve të partive politike në procesin parazgjedhor dhe gjatë zgjedhjeve;
- Thirrje për zgjedhje të vëzhguesve lokal dhe përzgjedhja e tyre;
- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të vëzhguesve lokal;
- Hartimi i *“Kalendarit të aktiviteteve”*.

Shkurtesat

AMFBZR – Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

AR – Agjencia e Rrugëve

NJVL – Njësia e Vetëqeverisjes Lokale

NP – Ndërmarrja Publike

QAE – Qendra për Analiza Ekonomike

MPEU – Ministria e Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit

MTV – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

MF – Ministria e Financave

RM – Republika e Maqedonisë

TM – Transparenca Maqedoni

1. Aktivitete të TIM

Zhvillimi i metodologjisë dhe veglave për monitorimin e shpenzimeve të partive politike për marketing politik në procesin parazgjedhor dhe gjatë zgjedhjeve

Ekipi i Transparency International Macedonia ka hartuar një metodologji të veçantë, me të cilën do të bëjë monitorimin e shpenzimeve të partive politike për marketing politik në nivelin lokal dhe kombëtar.

Gjatë hartimit të metodologjisë janë marrë në konsideratë: numri i banorëve në një vendbanim, sipërfaqja që e mbulon vendbanimi, numri i vendeve zgjedhore dhe numrin e votueseve të regjistruar në listën zgjedhore.

Metodologjia është e përbërë nga dy pjesë:

1. Monitorimi i shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike në procesin parazgjedhor dhe gjatë zgjedhjeve në nivelin kombëtar;
2. Monitorimi i shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike në procesin parazgjedhor dhe gjatë zgjedhjeve në nivelin lokal.

Sipas kësaj metodologjie do të zhvillohet monitorim i aktiviteteve vijuese të marketingut të partive politike:

Nivel kombëtar	Nivel lokal
TV kampanjë	TV kampanjë lokale
Radio kampanjë	Radio kampanjë lokale
Kampanjë në mediet e shtypura	Kampanjë në mediet e shtypura lokale
Internet (online) kampanjë	Reklamim i jashtëm (outdoor)
Reklamim i jashtëm (outdoor)	Mitingje të partive politike
Mitingje të partive politike	Mbledhje të qytetarëve
Mbledhje të qytetarëve	Materiale propaganduese
Materiale propaganduese	Marrje me qira e hapësirave partiake

Për nevojat e metodologjisë së zhvilluar janë krijuar më tepër vegla (dokumente, baza me të dhëna, vegla në Excel), pyetësor dhe formularë për monitorim në nivelin lokal dhe kombëtar, të cilat do të mundësojnë një platformë të monitorimit të shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike.

Thirrje për zgjedhje të vëzhguesve lokal dhe përzgjedhja e tyre

Thirrja për paraqitjen e organizatave aktuale joqeveritare të interesuara ishte publikuar në

TI-M dhe QAE kanë zbatuar identifikim dhe zgjedhje të organizatave lokale vëzhguese, gjatë së cilës ishin zgjedhur 8 organizata lokale dhe 16 vëzhgues.

Në këtë mënyrë në secilin prej 8 rajoneve të planifikuar ajanë zgjedhur 8 vëzhgues përgjegjës për monitorimin e shpenzimeve për aktivitete marketingu të partive politike dhe 8 vëzhgues përgjegjës për monitorim të shpenzimeve buxhetore.

	Organizata	Rajon (Komuna)
1	ZIP Instituti – Shkup / ZIP Institute-Skopje	Aerodrom, Gazi Babë, Qendër
2	Fokus - Veles / Focus - Veles	Veles, Kavadar, Çashka
3	DROM – Kumanovë / DROM - Kumanovo	Kumanovë, Kriva Pallanë, Kratovë
4	Eho Shtip / Eho - Shtip	Shtip. Koçanë, Karabinci
5	LDA Strugë /LDA Struga	Strugë, Ohër, Makedonski brod
6	Organizata e grave – Strumicë	Strumicë, Gjevgjeli, Bosillovë
7	CSO – Tetovë / CSO - Tetovo	Tetovë, Gostivar, Vrapçisht
8	MKC Manastir /MKC- Bitola	Manastir, Prilep, Novaci

Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të vëzhguesve lokal

Në periudhën 22-23 dhjetor ishte realizuar një trajnim i përbashkët i gjithë vëzhguesve të zgjedhur për dy temat e mbuluara me monitorimin. Ditën e parë, më 22.12.2015 QAE ka realizuar trajnimin për monitorim të shpenzimeve buxhetore në nivelin qendror dhe lokal ndërsa më 23.12.2015 TIM ka zbatuar trajnim për monitorim të shpenzimeve për marketing dhe aktivitete tjera të partive politike.

Me anë të këtyre trajnimeve, vëzhguesit lokal drejtpërdrejtë janë përfshirë në proceset e monitorimit dhe mënyrës së përdorimit të veglave.

Për nevojat e trajnimit janë përgatitur *udhëzime* të veçanta të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë vëzhguesit lokal gjatë përdorimit të veglave gjatë periudhës së parashikuar për monitorim.



- **Kalendari i aktiviteteve**

Sipas rregullores ligjore, Kodit Zgjedhor, për nevojat e projektit është përgatitur kalendar me datat e rëndësishme lidhur me Zgjedhjet Parlamentare të caktuara për 24.04.2016.

Data	Aktivitet
Jo më herët se 25.01.2016 – jo më vonë se 14.02.2016	Shpallje të Zgjedhjeve,
Jo më herët se 27.01.2016 – jo më vonë se 04.04.2016	Hapjen e llogarisë së posaçme për transaksion,
01.04.2016	Shpalljen e pjesëmarrësve në listën e kandidatëve
04.04.2016	Nisja e Kampanjës zgjedhore
14.04.2016	Raport financiar (të ardhura/të dala)
22.04.2016	Heshtja zgjedhore
24.04.2016	Zgjedhje
30.04.2016	Raport financiar (të ardhura/të dala)

Në përputhje me kodin zgjedhor, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike ka njoftuar që prej 20 dhjetorit 2015 në 00.00 ora hyn në fuqi ndalesa për transmetimin e reklamimit të paguar politik në programet e radiodifuzerëve, në mediet e shtypura dhe në mediet elektronike (internet portalet).




Shkup, 18.12.2015 – Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike i njofton gjithë mediet që të dielën, 20 dhjetor 2015, në orën 00.00 hyn në fuqi ndalesa për transmetimin e reklamimit të paguar politik në programet e radiodifuzerëve, në mediet e shtypura dhe në mediet elektronike (internet portalet).

Ndalesa është përcaktuar në Nenin 82, paragrafi 1 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 196/15) dhe vlen deri në ditën e fillimit të kampanjës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat do të zhvillohen në vitin 2016.

Aktivitetete të regjistruara të kampanjës politike

Paraprakisht, deri më 20 dhjetor, është vërejtur kampanjë intensive e paguar në formë të shpalljeve dhe video klipjeve nga ana e gjithë subjekteve politike.

Fushata ishte përfaqësuar në më tepër medie elektronike (televizione), internet portale, përfshirë edhe rrjetin social Facebook.

	<p>Video klip time.mk</p> <p>16.12.2015</p>
	<p>Video klip time.mk</p> <p>17.12.2015</p>
	<p>Video klip facebook.com</p> <p>17.12.2015</p>

	<p>Video klip fokus.mk</p> <p>18.12.2015</p>
	<p>Video klip libertas.mk</p> <p>18.12.2015</p>
	<p>Video klip plusinfo.mk</p> <p>18.12.2015</p>
	<p>Video klip time.mk</p> <p>18.12.2015</p>

3. Aktivitete të QAE

Pushteti qendror

- Vetëm një numër i vogël të publikimeve të përgjithshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (RM) dhe të përdoruesve buxhetor përmbajnë të dhëna financiare për investimet e bëra/planifikuara ose për publikimet në të cilat paralajmërohet investim i ri.

Tabela. Publikime dhe veçori të publikimeve të përdoruesve buxhetor për muajin dhjetor 2015

Përdorues buxhetor	Numri i plotë i publikimeve	Numri i publikimeve që përmbajnë të dhëna financiare	% e përmbajtjeve që përfshijnë të dhëna financiare	% e publikimeve që NUK përmbajnë të dhëna financiare
Qeveria e RM-së	85	23	27%	73%
MPPS	42	19	45%	55%
MTV	8	2	25%	75%
MF	17	4	24%	76%
AMFBZR	3	1	33%	67%
MBPEU	5	1	20%	80%
AP	1	0	0%	100%

- Publikimet madje më pak përmbajnë elaborat analitik të aktiviteteve të planifikuar/realizuar.
- Një pjesë modeste e publikimeve përfshijnë informacione për burimet e mjeteve, si dhe programet/strategjitë/planet mbi të cilat paralajmërohen ose (do të) realizojnë projektin e publikuar.
- Përqindja e publikimeve tek përdoruesit buxhetor që përmbajnë të dhëna financiare, analitike ose burim konkret të mjeteve, me përjashtim të MPPS, është nën 30%.
- Nga monitorimi i strukturës së publikimeve (synimi dhe projektet) të përdoruesve kryesor buxhetor vërehet që më dominuese në fokusin kanë qenë: fermerët dhe kategoritë e cenuara sociale (ndërsa në masë të vogël edhe nxënësit/studentët dhe penzionerët). Shikoni figurën më poshtë.




Figura. Publikime të përdoruesve buxhetor për përdorues i fondit të shërbimit të paralajmëruar plotësues

- Gjatë kohës së monitorimit, në muajin dhjetor, nga ana e QAE dhe TM janë dërguar gjithsej 12 kërkesa për qasje në informacione me karakter publik edhe atë në Qeverinë e RM-së (6), Ministrinë e Financave (2), Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve (1), Ministrinë e Bujqësisë, pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit (2), Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (1).
- Deri në momentin e përpilimit të këtij raporti është marrë përgjigje të një kërkesë dërguar tek AMFBZR. Bëhet fjalë për një publikim të muajit dhjetor dhe lidhet me pagesën e subvencioneve në bujqësi – duhan, të cilat janë realizuar në muajin maj. Duke marrë parasysh përdoruesit e fondit gjegjësisht numri i tyre i pagesës së dhënë konkrete që pothuaj se është 29 mijë fermerë, publikimi është një përkujtim për pagesën e këtij grupi të synimit pas shtatë muajve të kaluara.
- Përmbajtja e kërkesave të parashtruara ka të bëjë me atë nëse publikimet që përmbajnë një investim të caktuar është në përputhje me dokumentet strategjike të Qeverisë së RM-së si dhe nëse është bërë analizë paraprake për nevojat e këtij investimi si dhe për efektet përkatëse. Gjithashtu, kërkesa përmban edhe pyetje nëse investimet janë parashikuar në buxhetet e RM-së.

Pushteti lokal

- Në fazë të përpilimit të bazës me të dhëna.
- Trajnimi i vëzhguesve lokal është zbatuar.

Rezultatet priten për periudhën vijuese të raportimit.

4. Metodologjia e QAE

Gjatë muajit nëntor-dhjetor, ekipi ekspert i Qendrës për Analiza Ekonomike (QAE), ka zhvilluar një metodologji për monitorimin e shpenzimeve të buxhetit në nivelin qendror dhe lokal në Republikën e Maqedonisë (RM) gjatë periudhës parazgjedhore dhe gjatë zgjedhjeve të paralajmëruar në prill të vitit 2016. Zhvillimi i kësaj metodologjie është me interes të veçantë për RM-në duke marrë parasysh që ky aktivitetet nuk është zbatuar deri më tani në vend.

Metodologjia përbëhet nga dy pjesë:

1. Monitorimi i shpenzimeve buxhetore në nivelin qendror (zbatimi i buxhetit dhe monitorimi i publikimeve të përdoruesve buxhetor)
2. Monitorimi i shpenzimeve buxhetore në nivelin lokal (monitorimi i zbatimit tremujor të buxheteve komunale dhe monitorimi i shpenzimeve kapitale/operative),
 - Monitorimi në nivelin lokal ka edhe komponentë për ndjekjen e shpenzimeve në nivelin lokal nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, njësitë buxhetore dhe ndërmarrjet komunale nga ana e vëzhguesve të trajnuar lokal.

Metodologjia që do të monitorojë shpenzimet dhe publikimet për shpenzime nga qeveria, përdoruesit buxhetor, përfaqësuesit e tyre, vetëqeverisja lokale (mostër e zgjedhur) dhe përfaqësuesit e tyre do të zbatohet nga Transparency International Macedonia, QAE dhe nga organizatat partnere-vëzhgues lokal.

Për realizimin e metodologjisë së zhvilluar në periudhën vijuese ishin krijuar disa vegla (Google forms, Excel vegla, bazë me të dhëna), pyetësor dhe formularë që vëzhguesit lokal, QAE dhe TM, do të mundësojnë një platformë për monitorimin e shpenzimeve publike në periudhë vijuese.

Gjatë muajit të njëjtë është përpiluar një udhëzues që do të ndihmojë vëzhguesve lokal të përdorin veglat e përgatitura për nevojat e projektit. Para fillimit me monitorimin e shpenzimeve të buxheteve në nivelin lokal, ishte zbatuar një trajnim njëditor (22.12.2015) nga QAE dhe trajnim njëditor nga ekipi i TM (23.12.2015) në të cilat ishin prezantuar veglat të cilat vëzhguesit do të përdorin gjatë mbledhjes së informacioneve nga fusha, si dhe mënyrën e njoftimit.

Duke marrë parasysh që këtë periudhë fillestare (muaji dhjetor) i projektit ishte kryesisht i përqendruar në zhvillimin e metodologjisë, vendosjes së infrastrukturës për realizimin e aktiviteteve, zhvillimin e veglave, zgjedhje dhe trajnimi i vëzhguesve lokale dhe plotësimi i bazës me të dhëna, rezultate fillestare për pjesë të caktuara të raportit nuk mund të prezantohen.

Përmbajtja e plotë e raporteve mujore në vëllimin e tyre të planifikuar do të prezantohen gjatë muajit vijues.

Në këtë raport do të prezantohen struktura e përmbajtjes së planifikuar dhe do të prezantohet raporti i detajuar nga monitorimi i publikimeve të përdoruesve buxhetor¹ të cilën kemi bërë gjatë muajit dhjetor.

¹ Përdorues buxhetor janë përdoruesit e linjës së parë të buxhetit qendror të RM-së dhe fondeve jashtë-buxhetore. Ato nuk janë njësi buxhetore (shkolla, çerdhe, etj.) të cilat janë të përfshira me financat publike të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Ndërmarrjet publike janë njësi të veçanta shpenzuese që janë pronësi të njësisë së vetëqeverisjes lokale por financat e tyre që nuk janë të konsoliduar në financa publike të njësisë së pushtetit lokal dhe do të monitorohen nga vëzhguesit lokal.

5. Shpenzime buxhetore

Shpenzimi i buxhetit qendror

Metodologjia për monitorimin e shpenzimeve buxhetore në nivelin qendror - monitorim dhe analizë e raporteve mujore të publikuara nga Ministria e Financave të RM për zbatimin e buxhetit

Në këtë pjesë krijojmë një bazë të të dhënave (prej të dhënave nga zbatimi i Buxhetit 2008-2015.), I cili do të mundësojë përcaktimin e tendencave kryesore dhe efekteve sezonale në ciklet politike dhe ekonomike dhe dallimet në shpenzimet buxhetore jo vetëm në periudhën aktuale, por edhe krahasimi i tyre periudha e fundit (periudhën zgjedhore / periudhën jozgjedhore, etj.). Veç kësaj, përcaktohet grupi i mjeteve dhe treguesve me të cilat në mënyrë më drejtpërdrejte mund të ndiqen pozitat më të rëndësishme nga raportet mujore në periudhën parazgjedhore.

Indikatorë monitorimi të cilët do të ndihmojnë në ndjekjen e shpenzimeve të buxhetit:

I1: Realizim i zbatimit të buxhetit, % e zbatimit deri në periudhën.

I2: Zbatim mujor i buxhetit, vetëm për muajin aktual (muaji i fundit t-1).

I3: Realizim i zbatimit për pika të caktuara të raporteve:

- Paraqitje e lëvizjes së të ardhurave tatimore (mund të bëhet zgjedhje e lëvizjes së TVSH-së, tatimit mbi fitim dhe tatimit mbi të ardhurat).
- Paraqitje e lëvizjeve të të ardhurave jotatimore (mundet edhe tarifa gjyqësore dhe gjoba).
- Shpenzime (varësisht nga lëvizjet konkrete, kjo do të jetë e ndryshueshme):
 - o Lëvizje e (realizim procentual etj.): Shpenzime totale; Shpenzime rrjedhëse; Rroga dhe kompensime; Mallra dhe shërbime; Transferime sociale; Ndihmë sociale (mundet edhe kompensim për të papunësuar dhe për siguri shëndetësore – varësisht nga lëvizjet); Interes (i vendit – i huaj – varësisht nga lëvizjet në variablat); Shpenzime kapitale.
- Deficit buxhetor - lëvizje.

I4: Grafik i cili tregon krahasimin mes zbatim absolut, mesatarisht në muaj 1-12-ta sa do të jetë dhe mënjanim i efektit sezonal.

Shpallje publike në ueb faqet e Qeverisë dhe përdorues të zgjedhur të buxhetit

Monitorim i shpalljeve të përdoruesve të zgjedhur të buxhetit dhe ndërmarrjeve publike të cilët kanë lidhjen drejtpërdrejtë më të madhe me qytetarët. Në suaza të kësaj metodologjie ndiqen të gjitha masat/aktivitetet/politikat e shpallura të cilat drejtpërdrejtë ose jo-drejtpërdrejtë janë të lidhura me implikime fiskale, si dhe cilësia e të njëjtave në aspekt të informative të cilat i japin përdoruesit e buxhetit për aktivitetin e planifikuar/kryer.

Përveç të dhënave sasiore zyrtare të cilat mund të merren nga raportet mujore për Zbatim të Buxhetit të RM nga Ministria për financa, monitorimi përfshin edhe ndjekje të shpalljeve zyrtare në ueb faqet e përdoruesve kyç të buxhetit të cilët kanë lidhje drejtpërdrejtë më të madhe me qytetarët dhe të cilët janë tregues jo-drejtpërdrejtë për politikatat dhe aktivitetet të cilat planifikohen/zbatohen edhe atë:


- Qeveria e RM-së,
- Ministria për punë dhe politika sociale,
- Ministria për transport dhe lidhje,
- Ministria për financa,
- Ministria për ekonomi,
- Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave,
- Agjencia për komunikime elektronike,
- Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
- Agjencia për rrugë shtetërore.

Në suaza të kësaj metodologjie ndiqen të gjitha masat/aktivitetet/politikat të cilat drejtpërdrejtë ose jo-drejtpërdrejtë janë të lidhura me implikime fiskale (të shfaqura në aneks).

Ky monitorim përfshin kontrollim të ueb faqeve të përdoruesve të buxhetit, evidentohen të gjitha shpalljet dhe gjatë kësaj shënohet sa nga shpalljet përmbajnë:

- Të dhëna financiare për investimin e planifikuar/shpallur/publikuar;
- sa nga shpalljet kanë analitikë dhe program që e parasheh aktivitetin ose shpenzimin;
- sa nga shpalljet të cilat kanë të bëjnë me ndryshime të ligjeve kanë shpallur KNR (kontrollim të ndikimit të rregullores);
- në çfarë pjesë të shpalljeve janë dhënë burimet nga janë mundësuar mjetet për aktivitetin/projektin e shpallur/realizuar;
- cili është targeti – përdoruesi përfundimtar i investimit/projektit të shpallur;
- hap përfundimtar i monitorimit – metodologjia përfshin përgatitje dhe dërgim të kërkesës për qasje me informata me karakter publik për projekte/aktivitete të cilët kanë pasur implikime të rëndësishme fiskale dhe kanë rëndësi të veçantë për qytetarët.


Procesi i ndjekjes është treguar në grafikun në vijim.



Grafiku 1. Procesi i ndjekjes së shpenzimeve të shpallura të mjeteve nga buxheti i RM-së

Ndjekje e shpalljeve për periudhën e raportimit

Në tabelën në vijim mund të shihet numri i plotë i shpalljeve të cilat janë bërë në periudhën e raportimit në ueb faqen e përdoruesve të buxhetit të cilët monitorohen:



Grafiku 2. Numri i shpalljeve për shërbime sipas përdoruesve të buxhetit në periudhën e raportimit


Nga grafiku shihet se numri dominant i shpalljeve janë bërë nga Qeveria e RM-së dhe nga Ministria për punë dhe politika sociale.

Grafikët në vijim i ilustronë atributet e përmbajtjeve për investimet/aktivitetet e shpallura/realizuara të cilat përdoruesit e buxhetit i plasojnë tek qytetarët për muajin dhjetor në vitin 2015.


1) Qeveria e RM




2) MPPS e RM



3) TVM e RM



4) MF e RM



5) AMFBZHR

6) MBPEU



Si që mund të shihet nga tabela në vijim dhe nga grafikët e shfaqura më parë:

- **Numër i vogël i shpalljeve të plota të Qeverisë së RM dhe të përdoruesve të buxhetit përmbajnë të dhëna financiare për investimet e kryera/planifikuara ose për shpalljet për të cilat shpall investime të reja (Qeveria e cila ka më shumë shpallje – nën 30%).**
- **Të njëjtat edhe më pak përmbajnë elaborim analitik të aktiviteteve të planifikuara/realizuara.**
- **Pjesë mjaft e vogël e shpalljeve përmbajnë informata për burimin e mjeteve, si dhe programet/strategjitë/planet në bazë të të cilave e shpallin ose realizojnë projektin e shpallur.**

Përqindja e shpalljeve tek përdoruesit e buxhetit të cilët përmbajnë të dhëna financiare, analitike ose burim konkret të mjeteve, me përjashtim të MPPS, tek përdoruesit tjerë të buxhetit është nën 30%.


Tabelë. Shpallje dhe karakteristika të shpalljeve nga përdoruesit e buxhetit për muajin dhjetor në vitin 2015

Përdorues i buxhetit	Numër i plotë i shpalljeve	Numër i shpalljeve që përmbajnë të dhëna financiare	% e përmbajtjeve që përmbajnë të dhëna financiare	% e përmbajtjeve që nuk përmbajnë të dhëna financiare
Qeveria e RM	85	23	27%	73%
MPPS	42	19	45%	55%
TVM	8	2	25%	75%
MF	17	4	24%	76%
AMFBZHR	3	1	33%	67%
MBPEU	5	1	20%	80%
A. Rrugëve	1	0	0%	100%


Nga monitorimi i strukturës – shënjestrës të shpalljeve (gjegjesisht projekteve) të përdoruesve kyç të buxhetit shihet që më së shumti në fokus kanë qenë: bujqit dhe kategoritë e rrezikuara sociale (kurse në masë më të vogël edhe nxënësit/studentët dhe pensionistët).

Në grafikun në vijim janë shfaqur fushat për të cilat përdoruesit e buxhetit japin informata për qytetarët. Gjithashtu është shfaqur edhe përdoruesi përfundimtar për të cilin vlejnjë shpenzimet ose informatat.

Grafiku 3. Fusha të synuar me shpallje për shpenzime të rritura



Гrafiku 4. Përdorues të cilët janë synuar me shpallje për shpenzime të rritura



Gjatë monitorimit në muajin dhjetor janë dërguar gjithsej 12 kërkesa për qasje në informata me karakter publik edhe atë:

- Qeveria e RM (6).
- Ministria për financa (2).
- Ministria për transport dhe lidhje (1).
- Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujit (2).

Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillim rural (1)

Është marrë përgjigje për dy nga kërkesat e parashtruara.

- Për kërkesën e parë deri tek Qeveria e RM-së është marrë përgjigje që kërkesa e parashtruar nga ana jonë është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Për kërkesën e dytë është marrë përgjigje nga Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillim rural që ka të bëjë me shpallje nga muaji dhjetor, kurse lëndë e shpalljes paraqet pagesa e subvencioneve në bujqësi – duhan, të cilat janë realizuar në muajin maj. Në kontratë është shënuar programi dhe vlera e pagesës sipas kërkesës së parashtruar. Duke i marrë parasysh përdoruesit përfundimtar gjegjësisht numrin e tyre të pagesës së dhënë konkrete e cila është për gati se 29 mijë bujq shpallja është përkujtim për këtë grup të synuar edhe pas shtatë muajve të kaluar.

Përmbajtja e kërkesave të parashtruara ka të bëjë për atë nëse shpalljet që përmbajnë ndonjë investim është në pajtim me dokumentet strategjike të Qeverisë së RM-së, si dhe nëse është bërë analizë paraprake për nevojën nga një investim i tillë si dhe për efektet nga e njëjta. Gjithashtu kërkesa përmban edhe pyetje nëse investimet janë parashikuar në Buxhetin aktual të RM-së ose të ardhshmin e planifikuar.

Shpenzime nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale

Në monitorimin e shpenzimeve në nivel të qeverisë lokale, rolin e vetë do të kenë mbikëqyrës lokal dhe rezultatet e para priten në raportin për janar të vitit 2016. Shfaqim tregues indikativ të cilët do të mbikëqyren dhe do të llogariten.

Zbatimi tremujorësh i buxhetit të njësive të vetëqeverisjes lokale

I1: realizim i buxhetit në tremujorësh - shpenzime (24 ELS)

I2: realizim i shpenzimeve kapitale – 24 ELS në tremujorësh

Artikuj të përzgjedhur I3: realizim i shpenzimeve operative – 24 ELS për tremujorësh

Artikuj të përzgjedhur: I4: Shkallë e ndryshimit të pikave kryesore të buxhetit nga plani fillestar, me rebalanc përfundimtar (% rritje ose % zvogëlim për sa)

I3. Shkallë e ndryshimit të detyrimeve të komunës - 24 ELS për tremujorësh

Shpenzime të përzgjedhura kapitale/operative dhe ndjekje tek njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe shpenzime të NP themelore nga NJVL (Qyteti i Shkupit)

Në periudhën e ardhshme të raportimit.

6. Rregullorja ligjore

Gjatë realizimit të projektit janë marrë parasysh dispozitat pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë, me theks të veçantë në:

- **Kodi penal i RM**
- **Dispozitat në Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Kodit penal nga aspekt të kampanjës zgjedhore, paraqitjes mediatike dhe financim të zgjedhjeve** (“Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë”, nr. 196 prej 10.11.2015)
- **Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale** (“Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014 и 132/2014).

7. 7. Resurse dhe bashkëpunëtorë të jashtëm

Në realizimin e projektit, përveç ekipeve të TI-M dhe CEA, janë të përfshirë dhe do të marrin pjesë bashkëpunëtorë të jashtëm:

- Press Clipping MKD

Agjenci e cila kryen shërbime në pjesën e press clipping dhe dërgon raporte në bazë ditore për shpallje të mediave sipas fjalëve kyçe të përcaktuara prej më parë.

- D-r Zhaneta Popeska,

Profesor i rregullt në Fakultetin për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike (FINKI)

Agjencia për monitorim dhe matje të emetimit të materialeve të propagandës. Përveç kësaj do të përdoren edhe raporte nga monitorimi i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.